

SHPALLJE KËRKESE
Nr. 5443, datë 22.12.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtimi i godinës së re të mjekësisë së përgjithshme - godinë 8-katëshe në territorin e QSUT-së”- kredi.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të çmimeve të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 9,006,734.98 *(nëntë milionë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë.*

ZËVENDËSMINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Mira Rakacolli

**TABELA PËRMBLEDHËSE E LISTËS SË PRONARËVE DHE VLERA E SHPRONËSIMIT
PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT**

Ndërtimi i godinës së re të mjekësisë së përgjithshme-godinë 8-katëshe në territorin e QSUT-së

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaq e truallit	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e truallit në lekë	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i ndërtimit lekë/m ²	Vlera e ndërtimit në lekë	Vlera totale truall + ndërtesë	SHËNIME
1	8130	1/64	Rruga "Kongresi i Manastirit" Tiranë	Omer Malko Malko	230	30,196	6,945,080	108.25		2,061,654.98	9,006,734.98	Konfirmuar pronësia nga ZVRPP Tiranë , shkresë 11.12.2017, nr. 33314/2 prot.

SHËNIM:

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
2. Për ndërtesat social-ekonomike, vlerësimi është bërë bazuar në çmimet njësi të zërave të punimeve referuar listës së çmimeve për vitin 2016, për qytetin e Tiranës, publikuar nga EKB-ja.